- Two technical projects have been formulated for the investments in the road network and cleaning-up of drainage canals
- A scheme for the solid waste removal system has been prepared
- 3,000 meters of drainage canals were cleaned
- 1,200 square meters of public space opened for the residents of the area
- 12,800 square meters of road were upgraded in the neighborhood; 24,000 square meters of road were graveled in the project area
- Durrës Municipality has intervened in the area with four major investments

Objective 3

To organize and build capacities at the local level for the integration and development of the neighborhood, through elaboration of a Neighborhood Development Agenda

Performance indicators

- A Neighborhood Development Agenda Document was formulated
- Four trainings on local capacity building were organized in collaboration with CSDC
- 200 households, resident in the area, were involved in the process
- Two training days on lobbying and partnerships were organized in Macedonia; foreign language courses for students were delivered
- Two activities on environment were organized with participation of more than 180 participants
- A socio-economic study of the area has been conducted, with 385 questionnaires completed
- A platform for the integration of the local youth has been formulated, based on a study of the youth from the areas of Kënetë, Porto Romano, and Spitalla (257 questionnaires)

Objective 4

To disseminate knowledge among stakeholders and interested parties

Performance indicators

- Two issues of Informative Bulletins were prepared, with approximately 1,000 copies distributed
- Three television programs were transmitted; Austrian media broadcast the results of the Kënetë Project
- Visit of the Executive Director of ADA, Mr. Linhart; and two visits of the high officials from ADA in the area
- A project proposal has been formulated setting forth the continuity of the project





Project name	Implementation period	Donor	Fund	Implemented in
Steps towards an Inclusive Society in Elbasan: The Integration of Vulnerable Groups in Urban Development	December 2006 - December 2008	CORDAID Elbasan Municipality	€ 247, 538 Lekë 5 milionë	Elbasan Municipality

The design and implementation of this project were embedded in the City of Elbasan Development Strategy, which has been designed under the Enabling Good Urban Governance Program (EGUG II), and the National Strategy for the Amelioration of the Living Conditions of Roma Minority. The implementation of the project takes place in 5 Maji neighborhood, where the Roma community lives. This neighborhood faces various problems of a socio - economic nature, as well as regarding access to public services, while a situation of informality is pervasive. The initiated project aims at delivering activities that contribute to the integration of this community in the urban development of the city, so that the local community feel themselves as equal citizens in the future. Two main project dimensions are the carrying out of physical investments, based on an identification of priorities by the local community, and the design and publication of a local document on neighborhood development planning. It is the aim of this project to align the latter with the national strategy for Roma in Albania, so that it can serve as a measurement tool for the objectives accomplished at local level. An integral part of the project is the assistance provided to Roma population for capacity building, with the objective to increase their role in the local decision-making. Finally, by building capacities for the local government, the project aims at building bridges for a sustainable, institutional collaboration between local authorities and representatives of the Roma community in the area.



OBJECTIVES AND PERFORMANCE INDICATORS

Objective 1

To encourage and enable participation of Roma community in the decision making processes

Performance indicators

- 15 meetings were held with Roma community and their representatives in the area
- 2 trainings with the local residents were delivered, with approximately 60 participants

Objective 2

To empower local capacities on policy-making and practices that address the needs of Roma community in the society

Performance indicators

- Two manuals on the Roma issue were made available for use at Elbasan Municipality
- Representatives of Roma community have taken part actively in the participatory budgeting process undertaken by the Municipality

Objective 3

To increase awareness and lobbying capabilities among all local stakeholders and citizens on the Roma issue

Performance indicators

- A public awareness performance was organized in the main park of the city on the International Roma Day
- 1,000 Roma citizens took part in the event
- A network of partners working on Roma issue has been established

Objective 4

To improve access of the Roma citizens in physical and social infrastructure in order to improve their living conditions

Performance indicators

- A socio-economic study of the area where the Roma community lives was carried out, with 150 questionnaires completed
- Cooperation was made with lecturers and students of Elbasan University on carrying out of the abovementioned study
- 5 priority areas were listed by the Roma community, where the investments are to be based
- 6 technical projects were formulated for the interventions in the area

Project name	Implementation period	Donor	Fund	Implemented in
Strengthening capacities for Good Urban Governance	January – December 2007	OSFA/SOROS	\$ 71,240	Fier Municipality Durrës Municipality Korça Municipality Pogradec Municipality Lezhë Municipality

Local governments are facing enormous challenges, as on the one hand, the ongoing decentralization process is giving them more power regarding service provision and territorial management, and on the other, they have insufficient local capacities for effectively meeting these challenges and responding to these developments. Yet, there is a need for the engagement of civil society, transparency, and social responsibility. This project was created with the purpose of supporting local government units in such issues related to territorial planning and management, information management, and local budget formulation through a participatory process. In other words, the project aimed to enhance local capacities in the areas of governance and the dissemination of experiences developed by Co-PLAN in these areas to other municipalities. Ultimately, this project seeks to increase local transparency, accountability, and civic awareness in the field of local governance.

OBJECTIVES AND PERFORMANCE INDICATORS

Objective 1

To strengthen the managing capacities of local governments, in particular regarding the issues of urban planning, setting up and management of information systems and budgeting

Performance indicators

- Three training packages and manuals were prepared in areas of designing regulatory plans, municipal information systems, and participatory budgeting
- Four municipalities, Korçë, Pogradec, Durrës, and Lezhë, and a number of approximately 60 representatives, were the direct beneficiaries of these trainings

Objective 2

To enhance the transparency of local government by means of implementing tools for participation and monitoring

Performance indicators

- A methodology document for the implementation of the participatory budgeting process in Fier Municipality was designed
- About 700 citizens have taken part in the process
- 10,000 leaflets and 140 posters for information and sensitization were prepared and distributed
- Ten projects proposed by residents were financed from the municipal budget for the year 2008, amounting to a total of 50 million Lekë

Objective 3

To undertake sensitization campaign on the issues of local governance and transparency

Performance indicators

- Two talk shows on the issues of urban management were transmitted in TV NEWS 24
- Two talk shows in the field of local governance were transmitted in TV Vizion +
- Four articles were published in the "Metropolitan", "MAPO", magazines, etc.



Project name	Implementation period	Donor	Fund	Implemented in
Sustainable Energy for Albania	January 2006 – December 2007	Cordaid	€ 199,577	Study at national level

The incapacity of our hydroenergetic system to meet the ever-increasing demand for energy, coupled with its limited capabilities for importing the energy and huge technical and non-technical losses, have consequently brought the Albanian energy sector near collapse. The subsequent crisis of the energetic sector has also arisen due to lack of a vision to address the energetic issues and their impacts on the economic development of the country, through strategic decisions to invest in other alternative forms. The “Sustainable Energy for Albania” project aims at introducing a new concept in the energy policies of Albania, that is, that of a decentralized production of energy. It seeks to provide another perspective on the development of the energetic sector, taking into consideration the renewable sources of energy, in contrast to the National Strategy for Energy which is limited only to the centralized energy production relying on traditional sources. Upon its conclusion, the project is expected to achieve an increased awareness in the public opinion, among experts and the respective authorities on the issues of renewable energy (including also the production of H2 from renewable sources of energy), thus encouraging developments in the economic and environment areas in Albania.



OBJECTIVES AND PERFORMANCE INDICATORS

Objective 1

To create opportunities for a decentralized production of energy in Albania, as an alternative to the National Strategy for Energy

Performance indicators

- A study on "The Assessment of Potentials of Renewable Energy Sources in Albania" was published
- A study on the possibility of producing hydrogen from renewable energy sources and using it as a future energy source has been undertaken
- Action plan for encouraging the use of renewable energy sources in various sectors of economy was prepared
- Policy paper on the use of renewable sources of energy was formulated
- Signing of the Cooperation Agreement with the National Agency for Energy and an active participation in the working groups for updating of the National Strategy of Energy accomplished
- Formulation of three scenarios based on the use of renewable sources to produce energy in an decentralized manner was concluded
- Establishment and maintenance of a database on renewable energy sources
- 13 GIS maps were prepared for each renewable energy source

Objective 2

To highlight the importance of the role of renewable energy in the supply of energy in Albania in the long term

Performance indicators

- A meeting at national level and a roundtable on renewable energy, energy efficiency and the introduction and use of new technologies which use renewable sources of energy in Albania were organized
- Three short documentary films on the use of renewable energy sources in Albania were produced
- An exhibition on the renewable energy sources and efficient use of energy in housing was organized
- Broadcasting of the documentary film "The hydrogen Revolution" on television and other indoors events
- Participation in three television talk shows on the issues of energy
- Three articles published in daily newspapers
- More than 300 copies of the study on renewable energies and maps distributed to main institutions in Albania, to universities and experts of various related fields





Project name	Implementation period	Donor	Fund	Implemented in
Bridging Partnerships: The Design of the Urban Regulatory Plan of Berat City	June 2006 – June 2007	Cordaid	€ 100,000	Berat

The design of the Urban Regulatory Plan of Berat City took place under the "Bridging Partnerships" program, whose implementation has started in the year 2005. During 2007, this program was concentrated in Berat Municipality, a city that is facing the consequences of the out-migration of population. For this reason, the project intended to undertake a participatory planning process that would revitalize its urban centers and conserve its cultural heritage as well, following the demand of the municipality of Berat. Although initially the role of Co-PLAN was to conclude with the design of Urban Regulatory Plan, the qualification of Berat Municipality as a beneficiary of the World Bank funds, via the Land Administration and Managemenet project, the engagement of Co-PLAN in this project was finalized with the preparation of the Terms of Reference of the Plan. At this point, the work was concentrated in the mobilization and organization of the process, through setting up of a core structure and a cross-sectorial working group. Relevant surveys, analyses, and socio-economic studies were used for preparing the TORs. The latter document was approved at the national level by the Council for Territorial Adjustment of the Republic of Albania (KRrTRSh).

OBJECTIVES AND PERFORMANCE INDICATORS

Objective 1

To prepare the Terms of Reference for the Urban Regulatory Plan of the city of Berat

Performance indicators	➤ A socio-economic study of the city of Berat was conducted, for which 800 household questionnaires were carried out ➤ A database drawing on the situational analysis was established ➤ 26 departments, institutions and local enterprises were interviewed ➤ 3 thematic groups were established ➤ 33 thematic maps were produced ➤ ToR were approved at the national level by KRrTRSh
------------------------	---

Objective 2

To strengthen capacities at local level

Performance indicators	➤ 3 workshops were organized with municipal staff ➤ Ongoing on the job assistance / coaching provided to the working group
------------------------	---

Objective 3

To create a model for dissemination / replication in other local government units

Performance indicators	➤ Participation in the regional conference "Participatory Good Governance" ➤ Participation in the urban forum "Tomorrow's City" ➤ Four articles published in the municipal newspaper ➤ Five TV programs were broadcasted ➤ 2 agreements were concluded with the Faculties of Architecture and Urban Planning respectively
------------------------	---



Project name	Implementation period	Donor	Fund	Implemented in
NET Network for Exchange and Training	January 2004 — December 2007	Cordaid	€ 450,000	Consultancy and trainings offered in all the country
		Co-PLAN	€ 100,000	
		Generated from third parties	€ 145,506	

NET was established in the year 2004 as a joint program between Co-PLAN and Cordaid (the Netherlands). The focus of NET activities has been on delivering trainings and offering consultancy services in the fields of organizational management and development, along with activities aiming to promote values that are significant to the Albanian society. NET focuses on two main fields: (i) Trainings and Capacity Building on skills and content, in the areas of general management, organizational development, project cycle management, strategic planning processes, writing project proposals, business planning, financial management, and communication; and (ii) Processes aiming to identify and promote those values which are important for the society at large, such as through the annual Albanian Leadership Award.

A significant number of organizations and institutions have benefited from the services offered by NET, to mention the partners of the Cordaid and ICCO network in Albania, World Vision, SNV, Dorcas Aid Albania, Albanian Helsinki Committee, Refleksione, British Council, Raiffeisen Bank, Abisnet, GlaxoSmithKline, and many others.

OBJECTIVES AND PERFORMANCE INDICATORS

Objective 1

To identify and offer activities which aim at information exchange, networking, and knowledge dissemination

Performance indicators

- The Albanian Leadership Committee for the year 2007, consisting of distinguished figures, assessed 158 candidates nominated by the public via an open and transparent process
- Four Awards according to the four areas of leadership were given
- Approximately 130 people and many media have participated in the Award Ceremony

Objective 2

To develop and offer trainings, technical assistance, and capacity building which aim at supporting institutional and organizational development

Performance indicators

- Three new training curricula were introduced during 2007 ("Interviewing techniques" "Successful Sales Talk" and "Effective Decision-Making")
- 11 open trainings with about 90 participants from 28 organizations; and seven in-house trainings were delivered



PHOTO GALLERY














2007

ANNUAL REPORT



Co-PLAN INSTITUTE FOR HABITAT DEVELOPMENT

RAPORTI VJETOR

2007



Punuar në Shqip: JORIDA CILA
Përkthyer në Anglisht: JORIDA CILA
INDRIT FAJA
Korrektimi letrar: JORIDA CILA
INDRIT FAJA
Përpunimi Grafik: VIOLANA MURATAJ

Shtypur në:  **botime afrodit**

Foto Co-PLAN
Foto Galeri nga Violana Murataj

© CO-PLAN Instituti për Zhvillimin e Habitatit, Tiranë 2008



Co-PLAN

The logo features a large, thick black line forming a stylized house roof. Below the roof, on the left, is a grey silhouette of the map of Albania with a black line drawing of a person walking. To the right of the map is the text 'Co-PLAN' in a large, black, sans-serif font. A horizontal line separates the organization's name from its description.

INSTITUTE FOR HABITAT DEVELOPMENT
INSTITUTI PER ZHVILLIMIN E HABITATIT

RAPORTI VJETOR
2007

The title 'RAPORTI VJETOR' is in a black, sans-serif font. Below it, the year '2007' is in a large, light green, sans-serif font with a subtle drop shadow. A large, light green, irregular shape, resembling a stylized map of Albania or a splash, is positioned behind the title and year.

Përmbajtja



Fjala përshëndetëse e Drejtorit Ekzekutiv

Ngjarjet kryesore të vitit

Organizata jonë

Nga Co-PLAN në POLIS

Intervistë me ekspertin Peter Nientied

Financat e Co-PLAN

Projektet & Programet 2007

Foto-Galeri

Përshëndetje të nderuar miq,

Sikundër është kthyer në traditë, çdo vit Co-PLAN vjen tek ju me një përmbledhje të punës së vet vjetore. Edhe këtë herë ky botim ofron një pasqyrim të aktiviteteve dhe arritjeve kryesore në nivel projekti, si edhe në nivel organizate. Kjo jo vetëm në kuadër të komunikimit dhe transparencës, por edhe për të shkëmbyer eksperiencë të vlefshme në fushën e menaxhimit urban dhe të qeverisjes së mirë, ku Co-PLAN vazhdon të kontribuojë me përkushtim dhe profesionalizëm për shoqërinë shqiptare.

Viti 2007 ka shënuar disa zhvillime të rëndësishme për organizatën, ndër të cilat mund të përmendim shtrirjen e veprimtarisë në veri të vendit, përhapjen e modeleve të qeverisjes së mirë në njësi të ndryshme vendore, angazhimin në një nga projektet më madhore të Qeverisë Shqiptare e fokusuar në luftën kundër ekstra-legalitetit, si edhe kontributin e dhënë në nivel qendror përmes ndikimit në Strategjinë Kombëtare të Energjisë.

Co-PLAN ka besuar gjithmonë se në thelb të ndryshimit dhe zhvillimit qëndrojnë vetë njerëzit. Për këtë arsye, investojmë tek burimet njerëzore brenda organizatës, si edhe tek të gjithë partnerët tanë. Këtij besimi në filozofinë e pjesëmarrjes i dedikohen edhe puna dhe sukseset e arritura ndër vite, ku spikat bashkëpunimi dhe partneritetet e krijuara me komunitetet, shoqërinë civile, dhe me aktorë të qeverisjes vendore e qendrore.

Në mbyllje të kësaj fjale përshëndetëse, dua të shtoj se është vërtet kënaqësi të punosh me një staf profesional e të përkushtuar.



Dritan Shutina
Drejtori Ekzekutiv

Lidershipi Shqiptar

Pak histori . . .

Kudo në botë ekzistojnë praktika të reja apo të kthyer në traditë për të vlerësuar apo nderuar figura të ndryshme, kontributi i të cilëve është domethënës për zhvillimin e shoqërisë, qoftë ky kontribut i dhënë në fushën e shkencës, artit, sportit, etj. Nëpërmjet çmimit të Lidershipit Shqiptar, ne jemi përpjekur të sjellim këtë praktikë në Shqipëri.

Që prej vitit 2004, nën organizimin e Co-PLAN / NET, një Komitet profesionistësh angazhohet pikërisht për këtë qëllim: për të evidentuar dhe vlerësuar ata njerëz të cilët me punën e tyre sjellin një ndryshim pozitiv në shoqërinë shqiptare. Për çdo vit, ky Komitet akordon çmimet e mëdha të lider-shipit shqiptar në katër fusha: biznes, media, qeverisje dhe shoqëri civile.

Megjithëse fillimisht çmimi i Lidershipit Shqiptar është organizuar nga Co-PLAN, vit pas viti është parë një angazhim në rritje edhe nga individë apo institucione të tjera, duke rritur legjitimitetin e këtij çmimi vlerësues, rrjedhimisht edhe impaktin e tij. Është një nga synimet tona që kjo praktikë të kthehet në një traditë dhe të shërbejë edhe për afirmimin e këtyre figurave të shquara si edhe të vendit tonë në nivel ndërkombëtar.

Megjithë periudhën e gjatë të tranzicionit në vend dhe vështirësitë nëpër të cilat po kalon shoqëria jonë, ka gjithnjë individë, qytetarë të ndërgjegjshëm dhe të përgjegjshëm, të cilët meritojnë të vlerësohen publikisht për kontributin e dhënë për të sotmen dhe të nesërmen e vendit. Shoqëria jonë është duke krijuar liderët e vet, ne thjesht duhet t'i mbështesim ata.





Për vitin 2007

Komiteti i Leadershipit Shqiptar për vitin 2007, strukturë e cila vlerëson kandidaturat dhe përzgjedh fituesit, përbëhej nga figura të njohura në vend, si Znj. Valentina Leskaj, Znj. Ariana Fullani, Z. Besnik Aliaj, Z. Edmond Spaho, Z. Avni Ponari, Z. Arjan Çani dhe Z. Dritan Shutina.

Kriteret e vlerësimit të kandidaturave, megjithëse specifike për secilën kategori, kanë të përbashkët vlerësimin e ndikimit që veprimtaria e secilit ka patur në zhvillimin e vendit, në demokratizimin e tij, në sjelljen e praktikave apo standardeve të reja të cilat në thelb synojnë të përmirësojnë mbarë shoqërinë shqiptare dhe që shërbejnë si një model nga i cili mund të frymëzohen brezat e rinj.

Për vitin 2007, fituesit e nderuar të këtij çmimi sipas kategorive u shpallën:

Biznes – Z. Avenir Kika, kryesisht për kontributin e tij në dhurimin e hapësirave publike dhe ndërtimin e një shkolle të mesme në zonën e Selitës.

Shoqëri Civile – Z. Remzi Lani, për kontributin e dhënë në fushën e gazetarisë në kultivimin e një kulture tolerante dhe bashkëjetese demokratike.

Qeverisje Lokale – Institucionit të "Avokatit të Popullit", i cilësuar si një domosdoshmëri e shoqërisë shqiptare duke vepruar gjithnjë në mbrojtje të interesave të qytetarëve, subjekteve private dhe institucioneve të pavarura, dhe mbi të gjitha për konsolidimin e demokracisë.

Media – Z. Sokol Balla, si një personalitet i medias shqiptare që ka nxitur mendimin e lirë dhe të pavarur, i spikatur për etikën dhe neutralitetin profesional.

Co-PLAN dhe Partnerët e tij,

Falenderim i veçantë për Cordaid

Një pjesë e rëndësishme e formimit, rritjes dhe profesionalizmit të organizatës i dedikohet partnerëve strategjikë që Co-PLAN ka patur ndër vite. Këtu dëshirojmë të vlerësojmë mbështetjen e donatorëve të tillë si, Cordaid, Ambasada e Mbretërisë së Holandës, NOVIB, IHS, OSI/OSFA, krahas partneriteteve me agjensi zhvillimi si Komisioni Evropian, Banka Botërore, PNUD, ADA, SNV, etj. Ndërmjet mjaft donatorëve dhe partnerëve tanë, këtë vit dëshirojmë të veçojmë njërin prej tyre, pikërisht fondacionin Holandez Cordaid, i cili ka mbështetur organizatën që në fillimet e veta. Madje, Co-PLAN mund edhe të konsiderohet si një produkt i strategjisë së Cordaid për fuqizimin e kapaciteteve vendore.

Nëpërmjet këtyre rreshtave, ne dëshirojmë të falenderojmë publikisht Cordaid, si edhe bashkëpunëtorët dhe donatorët e kësaj organizate, për të gjithë mbështetjen që i kanë dhënë shoqërisë Shqiptare përgjatë viteve të vështira të tranzicionit drejt një shoqërie të zhvilluar e demokratike. Falenderime të veçanta shkojnë për dy prej përfaqësuesve të kësaj organizate, Z. Jup van Zijl dhe Znj. Elly Rijnens, jo vetëm si dy partnerë të rëndësishëm dhe dashamirës të vendit tonë, por edhe si dy miq të organizatës.





Shqipëria në epokën e Energjive të Rinovueshme

Ekspozita e burimeve të rinovueshme të energjisë ishte një aktivitet përmbyllës i të gjithë fushatës së gjerë mediatike të ndërmarrë nga Co-PLAN në kuadër të projektit “Energjitë e Qëndrueshme për Shqipërinë” me objektiv kryesor ndërtimin e një platforme komunikimi dhe debati si edhe harmonizimin e pikëpamjeve dhe këndvështrimeve të ndryshme për sa i përket potencialeve të burimeve të rinovueshme të energjisë. Në këtë ekspozitë u prezantuan për herë të parë hartat e potencialeve për çdo burim të rinovueshëm të energjisë si edhe u bë promovimi i librit “Studim mbi Potencialet e Burimeve të Rinovueshme në Shqipëri”.

Data e organizimit të këtij eventimenti ishte gjithashtu kuptimplotë. 1 Qershori, dita e fëmijëve, nëpërmjet kësaj konference erdhi si një simbol i vazhdimësisë së jetës dhe nevojës sonë për burimet alternative të energjisë për të mundur vazhdimësinë e saj.



Demokracia me Pjesëmarrje – eksperiencia nga bota dhe vendi ynë

Në Dhjetor 2007, rajoni Rhône-Alpes në Francë, organizoi një aktivitet i cili jo pa qëllim u quajt Takimi Botëror i Demokracisë me Pjesëmarrje. Thelbi i këtij aktiviteti ishte prezantimi dhe diskutimi i praktikave ndërkombëtare të demokracisë me pjesëmarrje nga niveli lokal në atë global duke mundësuar shkëmbime eksperiencash mjaft të vlefshme jo vetëm për demokracitë në zhvillim, por edhe për demokraci të konsideruara "të konsoliduara", si ato të Evropës perëndimore.

Mbi 1,500 pjesëmarrës nga e gjithë bota legjitimuan natyrën globale të këtij aktiviteti, në të cilin Shqipëria u përfaqësua nga Co-PLAN, eksperiencia dhe praktikat e të cilit në planifikimin dhe buxhetimin me pjesëmarrje në nivel vendor tërhoqën vëmendjen e një publiku mjaft të interesuar.

Ky takim i madh tregoi se demokracia me pjesëmarrje, së bashku me decentralizimin, është pjesë e një lëvizjeje e cila në një periudhë afatgjatë mund të ndryshojë modelet tona të demokracisë, duke sjellë ndryshime jo të pakta edhe në modelet tona për zhvillim.

Ku qëndrojmë ne në këtë nismë globale?

Njerëzit qëndrojnë në thelb të punës sonë pasi ne jemi të ndërgjegjshëm për rolin e pjesëmarrjes qytetare në vendimmarrje për të mundësuar zhvillim të qëndrueshëm dhe për t'i bërë qytetet tona më të jetueshme duke përmirësuar ndjeshëm cilësinë e jetesës. Që në fillimet e saj, organizata jonë ka praktikuar planifikimin me pjesëmarrje në fusha të ndryshme e në nivele të ndryshme, me një shtrirje gjeografike që mbulon një pjesë të madhe të Shqipërisë. Kjo falë filozofisë së punës sonë dhe të partnerëve tanë.

Co-PLAN ka aplikuar me sukses pjesëmarrjen qytetare në planifikimin e territorit të qytetit, planifikimin mjedisor, e deri në alokimin e buxhetit bashkiak me pjesëmarrje, kjo e fundit e cilësuar si një nga praktikat më të larta të pjesëmarrjes dhe të ushtrimit të demokracisë së drejtpërdrejtë. Në të gjitha projektet tona, ndërgjegjësimi qytetar dhe i shoqërisë civile në përgjithësi për rolin e tyre në planifikimin dhe menaxhimin e qytetit ku ata banojnë, por edhe më gjerë, cilësohet si guri i themelit dhe kyçi për një zhvillim të qëndrueshëm. Co-PLAN ka patur mundësinë t'i prezantojë këto eksperiencia në aktivitete të rëndësishme ndërkombëtare, kryesisht në Evropë, por edhe në Amerikën Latine e atë të Veriut, jo rrallëherë duke u vlerësuar edhe me çmime të ndryshme.

Seria e Botimeve

Prej disa vitesh botimet profesionale janë kthyer në një pjesë përbërëse dhe shpeshherë identifikuese të organizatës, si një nga mënyrat që ne kemi zgjedhur për të rritur më tej kontributin tonë për zhvillimin e vendit. Ky vit nuk ka qënë i ndryshëm në këtë drejtim, duke kurorëzuar botimin e dy librave mjaft cilësorë, me vlera akademike si edhe praktike.

Studimi “Vlerësimi i Potencialit të Burimeve Alternative të Energjisë në Shqipëri”

E gjithë bota po përballët çdo ditë e më shumë me nevojën emergjente për të investuar në burime alternative të energjisë, në një kohë kur sistemi aktual i vendit tonë është tërësisht i varur në energjinë hidrike. Ky fakt ngre mjaft dyshime dhe pasiguri në lidhje me qëndrueshmërinë, në një kohë kur kërkesa është gjithnjë në rritje. Kështu pra, një nga sfidat më të mëdha të sektorit energjitik në Shqipëri është diversifikimi i burimeve të energjisë, duke rritur prodhimin e brendshëm e duke ulur varësinë ndaj importit.

Studimi “Vlerësimi i Potencialit të Burimeve Alternative të Energjisë në Shqipëri” fokusohet pikërisht në këtë fushë. Ai përfshin një vlerësim hapësinor dhe sasior të burimeve të rinovueshme të energjisë, duke identifikuar vendndodhjet e tyre si edhe potencialet përkatëse. Ky studim gjithashtu kryen një analizë historike të burimeve të energjisë të përdorur nga sektorë të ndryshëm të ekonomisë, si edhe një projektion të kërkesës dhe ofertës për energji për 25 vitet e ardhshme.



Studimi “Vlerësimi i Potencialit të Burimeve Alternative të Energjisë në Shqipëri”



Botimi në shqip i librit “Misteri i Kapitalit”, nga Hernando de Soto.

Libri Misteri i Kapitalit

I botuar fillimisht në vitin 2000, cilësohet si një nga ikonat e literaturës dhe teorisë së zhvillimit dhe si i tillë është përkthyer në disa gjuhë. Në mënyrë të thjeshtë, të pastër e të qartë, ky libër parashtron dhe analizon faktorët të cilët pengojnë zhvillimin e vendeve më të varfra. Sipas teorisë së de Sotos, dy shtyllat bazë për të garantuar reforma të suksesshme dhe një zhvillim ekonomik si në perëndim, janë formalizimi i ekonomisë ekstraligjore dhe respektimi i të drejtës së pronës. Vetëm në këtë mënyrë “kapitali i vdekur mund të ringjallet” dhe ekonomitë e botës së tretë të mëkëmben.


Duke vlerësuar rëndësinë e kësaj përjasje në kontekstin shqiptar, Co-PLAN, edhe në cilësinë e një prej avokatëve të parë të formalizimit dhe legalizimit në Shqipëri, e sjell këtë libër për të gjithë lexuesit shqiptarë të cilët paraqesin interesa akademike apo praktike mbi çështjet e zhvillimit.



Ekselencia Shqiptare 2007

Çmimi “Ekselencia Shqiptare” i organizuar nga Qendra Shqiptare e Ekselencës, nderon çdo vit profesionistë dhe akademikë të dalluar në vendin tonë. Për vitin 2007, ky çmim ju akordua Co-PLAN Instituti për Zhvillimin e Habitatit me motivacionin “për kontribut të spikatur kërkimor-shkencor në fushën e zhvillimit urban dhe atij rajonal në disa qytete të Shqipërisë”.









Fushat e veprimtarisë


Siç e shpreh më së miri vetë misioni i organizatës, Co-PLAN kontribuon për zhvillimin e qëndrueshëm urban e rajonal duke mbështetur qeverisjen e mirë, zhvilluar shoqërinë civile dhe duke fuqizuar komunitetet. Për këtë arsye edhe shërbimet e organizatës i drejtohen pushtetit lokal, organizatave të shoqërisë civile si edhe komunitetit dhe përqëndrohen në fushat e menaxhimit urban, planifikimit strategjik, menaxhimit mjedisor, zhvillimit rajonal dhe zhvillimit institucional dhe organizativ, gjithnjë duke respektuar filozofinë e pjesëmarrjes që karakterizon organizatën. Gjithashtu, konsulencat afatshkurtra të lidhura me kërkimin shkencor kanë qënë gjithnjë pjesë e punës së organizatës, e cila tashmë zotëron eksperiencën e duhur për dizajnimin dhe zbatimin e studimeve kërkimore në fusha të ndryshme.

Vitet e fundit organizata ka rritur paraqitjen dhe rolin e vet në jetën publike të vendit, kryesisht nëpërmjet pjesëmarrjes dhe kontributit të dhënë në debate të ndryshme në rrafshin e politikëbërjes. Vlen për tu veçuar kontributi i dhënë në diskutimin e Strategjisë Kombëtare të Energjisë, apo mbi dukuri të caktuara si zhvillimi informal në vend, legalizimet, etj. Nëpërmjet këtij angazhimi organizata kërkon të sjellë në sferat më të larta të politikëbërjes dhe vendimmarrjes eksperiencën praktike të fituar gjatë 12 vjetëve të ekzistencës së vet.

Zhvillimi i vazhdueshëm i organizatës ka mundësuar diversifikimin e projekteve të zbatuara përgjatë viteve si edhe ka çuar në rritjen e shtrirjes gjeografike të asistencës së ofruar. Kjo reflekton më së miri edhe rëndësinë që ne i kushtojmë zhvillimit rajonal, si një nga kyçet e suksesit për një të ardhme të qëndrueshme.

Co-PLAN 2007





Struktura organizative e Co-PLAN

Co-PLAN drejtohet nga një Drejtor Ekzekutiv, i cili këshillohet vazhdimisht me Bordin Drejtues të organizatës si edhe me Bordin Këshillimor. Megjithatë, është vetë stafi ai që përbën thelbin e organizatës nëpërmjet angazhimit të drejtpërdrejtë në zbatimin e projekteve të ndryshme dhe arritjen e rezultateve të dukshme e të prekshme, ndërkohë që strukturat drejtuese punojnë për të rritur rrjetet e bashkëpunëtorëve si edhe për të pozicionuar më fort Co-PLAN në shoqërinë profesionale shqiptare.

Fundi i vitit 2007 ka shënuar edhe lançimin e NET Rrjeti për Shkëmbime dhe Trajnim si organizatë e pavarur nga ajo mëmë. NET vazhdon të ofrojë trajnime dhe shërbime konsulence në lidhje me menaxhimin dhe zhvillimin organizativ, menaxhim projekti dhe programi, menaxhim të burimeve njerëzore, etj.



Stafi i Co-PLAN

Më shumë se gjysma e stafit të Co-PLAN zotëron një gradë apo titull shkencor, të fituara kryesisht nga universitete me emër në Evropë dhe Amerikë, dhe të gjithë ndajnë përkushtimin dhe dëshirën e madhe për të punuar dhe për të kontribuar për vendin tonë.

Një pjesë e stafit të organizatës angazhohet edhe në mësimdhënie, si në universitetet publike ashtu edhe në ato private. Kjo është një nga mënyrat se si ne kontribuojmë në edukimin e brezave të ardhshëm. Mjaft studentë nga universitete të ndryshme, e veçanërisht nga ato publike, përdorin gjerësisht bibliotekën e Co-PLAN si edhe konsultohen me ekspertët e organizatës, të cilët jo rrallë kanë supervizuar temat e diplomave për një numër të madh studentësh shqiptarë. Në vijim të përpjekjeve të organizatës për të investuar në talentet e reja, vlen të përmendet edhe praktika shumë-vjeçare e Co-PLAN për të tërhequr pranë stafit të saj studentë të viteve të fundit; një pjesë e madhe e të cilëve integrohen mjaft mirë në organizatë duke u kthyer pas disa vitesh në ekspertë të mirëfilltë në fushat tona të veprimtarisë.





Bordi drejtues i organizatës

Znj. Valdet Sala dhe Z. Sef Slootweg, pas një kontributi shumëvjeçar të dhënë për organizatën në cilësinë e anëtarit të Bordit Drejtues, duke filluar nga ky vit, bëhen pjesë e Bordit Këshillimor të Co-PLAN. Vendin e tyre e zënë dy anëtarë të rinj, Z. Besnik Aliaj dhe Z. Sotir Dhamo. Nëpërmjet këtyre rreshtave dëshirojmë të falenderojmë për kontributin e tyre të çmuar Znj. Valdet Sala dhe Z. Sef Slootweg.



Besnik Aliaj
Anëtar

Diplomuar në Arkitekturë-Urbanistikë nga Universiteti i Tiranës. Më pas ka marrë titullin Master në Zhvillim dhe Menaxhim Urban nga Universiteti Erasmus dhe IHS-Rotterdam Holandë. Në vitin 2007 mbron titullin “Doktor i Shkencave”

në Universitetin Politeknik të Tiranës. Dy vite eksperience pune ne qeverisjen vendore, dhe 17 vjet eksperience akademike prane Universitetit Politeknik, Akademise se Arteve te Bukura, Universitetit “Polis” Tirane; dhe Universitetit Teknik të Darmstad, Gjermani. Eksperiencë 10 vjeçare me shoqërinë civile. Bashkëthemelues dhe ish-drejtues i Co-PLAN. Sekretar i Përgjithshëm i Shoqatës së Arkitektëve të Shqipërisë. Bashkëthemelues i Platforma-IDR, Instituti për Demokraci e Reforma. Këshilltar i Kryeministrit për territorin në periudhën 2005/7. Bashkëthemelues dhe Rektor i Universitetit “Polis”. Autor i disa botimeve profesionale.



Sokol Çelo
Drejtor i Bordit

Sokol Çelo po kryen studimet e doktoraturës për Biznes Ndërkombëtar në “Florida International University” duke u specializuar në këndvështrimin institucional të investimeve të huaja në vendet ish-komuniste dhe ato në tranzicion. Më parë është diplomuar si matematikan në Universitetin e Tiranës dhe më tej ka përfunduar programin Master

në Administrim Biznesi të ofruar nga Universiteti i Tiranës dhe ai i Nebraskës. Karriera e tij profesionale filloi në fushën akademike si pedagog i matematikës në Universitetin e Tiranës, dhe vazhdoi më tej në fushën e projekteve zhvillimore duke punuar si menaxher projekti për GTZ dhe më vonë për PNUD. Është anëtar dhe Kryetar i Bordit Drejtues të Co-Plan që prej vitit 2002.



Sotir Dhamo
Anëtar

Diplomuar si Planifikues Urban nga Universiteti i Tiranës; më pas fiton titullin Master në Administrim Publik nga Universiteti i Sirakuzës, ShBA. Ka ndjekur programe të ndryshme pasuniversitare në disa vende të Evropës. Eksperiencë e gjatë në mësimdhënie, si në universitetin publik ashtu edhe në atë privat. Një

nga bashkë-themeluesit e Universitetit POLIS, ku aktualisht kryen funksionin e Administratorit të Përgjithshëm, pa lënë pas dore edhe mësimdhënien. Autor i disa artikujve të botuar në gazeta dhe revista lokale apo të prezantuara në aktivitete ndërkombëtare. Eksperiencë e gjatë pune në administratën publike si edhe në shoqërinë civile, me fokus në hartim dhe zbatim projektsh, hartime planesh rregulluese, si edhe në zhvillim institucional dhe forcim organizativ. Ka punuar pranë Co-PLAN për rreth 5 vjet, ku edhe ka qënë anëtar i Bordit Ekzekutiv të organizatës.

Bordi Këshillimor i Co-PLAN



Peter Nientied është një nga bashkëpunëtorët e ngushtë të organizatës që në fillimet e saj dhe aktualisht është konsulent në fushën e zhvillimit organizativ dhe menaxhimit si edhe partner pranë De Boer & Ritsema van Eck (Holandë). Ai zotëron dy tituj Master, në Gjeografi Njerëzore dhe Planifikim & Menaxhim Publik, dhe ka mbaruar studimet e doktoraturës në Shkenca Sociale. Ai ka punuar për disa vite për IHS, (Universiteti i Erasmusit, Rotterdam)

ku ka ndërmarrë një sërë projektesh zhvillimore, kërkim dhe konsulencë në vende të ndryshme të Azisë, Amerikës Latine dhe Evropës. Fushat e tij të ekspertizës janë zhvillimi organizativ, zhvillimi i leadershipit dhe menaxhim projekti, mbi të cilat jep edhe një sërë trajnimesh dhe kurse Masteri



Valdet Sala ka qënë anëtare e Bordit Drejtues të Co-PLAN nga viti 2002 deri në vitin 2007 dhe konsulente e jashtme e organizatës që nga viti 1999. Aktualisht, ajo është menaxhere e një programi të GTZ/GOPA në përfshirjen e shoqërisë civile. Në karrierën e saj profesionale, Znj. Sala ka mbajtur poste të rëndësishme si Drejtoreshë e Bibliotekës Kombëtare, Drejtoreshë Programi tek Soros dhe si konsulente mbi shoqërinë civile dhe çështjet

gjinore. Ajo është themeluese e tre organizatave të cilat veprojnë kryesisht në çështjet gjinore, dhe ka botuar një numër artikujsh mbi këto çështje, si edhe ka përfaqësuar lëvizjen e femrave shqiptare në aktivitete kombëtare dhe ndërkombëtare. Në vitin 2005 asaj ju akordua çmimi Leadershipi Shqiptar për kontributin e vyer në sferën e shoqërisë civile.



Sef Slootweg është një nga bashkë-themeluesit e Co-PLAN. Ai ka punuar për shumë vite për zyrën Holandeze për kërkim dhe këshillim të politikave, kryesisht në çështjet urbane dhe sfidat e banesave sociale. Në vitin 1990 ai themeloi fondacionin Crossover me synimin për të shkëmbyer eksperiencën në fushën e strehimit ndërmjet ekspertëve Holandezë dhe atyre Shqiptarë. Kjo ishte

shtytja për të ardhur në Shqipëri, ku Z. Slootweg u angazhua me studimet mbi rritjen e shpejtë dhe informale të zonave rezidenciale në Tiranë. Në vitin 1999 ai u atashua pranë SNV.



Ferry van Wilgenburg ka një eksperiencë të gjatë ndërkombëtare në fushën e menaxhimit urban, në veçanti në vendet Aziatike. Në Holandë, ai ka punuar për pesë vjet në Bashkinë e Rotterdemit, në pozicionin e menaxherit të programit për zhvillimin e lagjes dhe si menaxher i pasurive të paluajtshme.


Aktualisht ai punon në një korporatë të banesave sociale, si menaxher i pasurive të paluajtshme.




John Driscoll është Drejtori i Qendrës Ndërkombëtare për Zhvillim Lokal dhe Rajonal (ICLRD), një qëndër e kërkimit të aplikuar me vendndodhje në Armagh, dhe është frut i një partneriteti Veri –Jug –ShBA ndërmjet universiteteve dhe qëndrave kërkimore të përfshira në planifikimin hapësinor dhe subjekte të ngjashme. Z. Driscoll është gjithashtu Zv/President i Institutit për

Zhvillimin Urban Ndërkombëtar në Kembrixh, Masaçusets, dhe një kërkues shkencor në Qendrën për Studime të Strehimit të universitetit të Harvardit. Gjatë viteve 1989 -2005, ai ka qënë një kërkues shkencor i asociuar dhe pedagog i Planifikimit Urban në Qendrën për Studime të Zhvillimit Urban, pranë universitetit të Harvardit.

Pikat kyçe përgjatë zhvillimit të organizatës





Nga Co-PLAN në POLIS Vizioni ynë për të ardhmen

Pa dyshim që e gjithë Shqipëria pësoi ndryshime të rëndësishme pas viteve '90, ku qytetet në veçanti pësuan transformime të paimagjinuara më parë. Këto ndryshime u shfaqën në morfologjinë, tipologjinë, funksionalitetin dhe në vetë pëlhurën sociale të qyteteve, duke i kthyer ato në laboratorë urbanë si për akademikë ashtu edhe për profesionistë të shkencave të zhvillimit.



Në këtë bum zhvillimi, Co-PLAN erdhi si një alternativë e re e menaxhimit të territorit në zonat urbane, e në veçanti në ato informale, duke ofruar zgjidhje bashkëkohore dhe efikase për administrimin e hapësirës dhe territorit me pjesëmarrje të gjerë qytetare. Duke ndërtuar hap pas hapi mbi eksperiencën e fituar, Co-PLAN arriti që ndër vite të shtrijë fushat e saj të ekspertizës dhe të rrisë profesionalizmin, duke u kthyer në një nga organizatat më prestigjioze në vend në çështjet e zhvillimit urban dhe atij rajonal.

Me një dëshirë, vullnet dhe përkushtim profesional për zhvillimin e vendit, Co-PLAN nuk e kufizoi kontributin e vet në hartim dhe zbatim projektsh. Para dy vjetësh u arrit të materializohej edhe një ëndërr e themeluesve të saj, ngritja e një institucioni të arsimit të lartë i cili trajton çështjet e zhvillimit urban sipas një kuadri dhe metodologjie bashkëkohore. Kjo shënoi një kapërcim gjigand për organizatën duke e kaluar kështu në një tjetër nivel atë eksperiencë të vyer që Co-PLAN ka mundur të gjenerojë dhe të ofrojë gjatë 12 viteve të ekzistencës së vet. "POLIS" Shkolla Ndërkombëtare e Arkitekturës dhe Planifikimit Urban është një institucion akademik i cili është ndërtuar pikërisht mbi modelet dhe eksperiencat e përfituara nga stafi i Co-PLAN dhe ai i partnerëve të tij përgjatë viteve, dhe ku Co-PLAN kontribuon jo vetëm nëpërmjet eksperiencës së vet praktike në këtë drejtim, por edhe me vetë stafin e saj.

Rinia është e ardhmja e vendit, dhe një rini e arsimuar mirë do të thotë një e ardhme e mirë. Për këtë, Co-PLAN e cilëson themelimin e Universitetit si lartësimin e përpjekjeve shumëvjeçare të organizatës dhe si një investim të sigurtë për zhvillimin e vendit tonë.



Dhjetë vjet me Co-PLAN: Intervistë me Dr. Peter Nientied

Organizata e parë nga këndvështrimi i një konsulenti të jashtëm

Përse jeni pjesë e këtij raporti vjetor?

Viti 2007 shënon edhe vitin tim të 10të të angazhimit si konsulent apo trajnues për Co-Plan. Çdo vit kryej të paktën 2 ose 3 vizita pune në Shqipëri. Unë kam ndihmuar Co-PLAN në hartimin e projekt-propozimeve, dizenjimin dhe zbatimin e projekteve vlerësuese, kam ofruar trajnime të ndryshme në lidhje me tematikat e menaxhimit, e kështu me radhë.

Kur filloi bashkëpunimi juaj me Co-PLAN?

Kur unë punoja në Institutin e Studimeve të Strehimit dhe Zhvillimit Urban në Rotterdam të Holandës, unë u angazhova me supervizimin e tezave të Masterit apo edhe të Diplomave të kurseve të ndryshme të disa pjesëmarrësve nga Shqipëria. Kjo eksperiencë ka filluar në vitin 1994 e ka vazhduar pothuajse e pandërprerë. Në vitin 1995 unë erdha për herë të parë në Shqipëri, për të punuar me Institutin e Urbanistikës, ku drejtova një kurs mbi menaxhimin e ndërtimeve të jashtëligjshme.

Përse vazhdoni të vini në Shqipëri, dhe përse Co-PLAN ju kërkon të vini këtu?

Në thelb, unë jam i motivuar për të mbështetur vlerat të cilat qëndrojnë në themel të Co-Plan, dhe për mua ato janë risi, cilësi dhe kontributi që Co-Plan sjell për shoqërinë Shqiptare. Për më tepër, puna e Co-Plan udhëhiqet nga një frazë në të cilën unë besoj thellësisht: Praktiko, apo bëj atë që thua. Kjo do të thotë: puno fort për të arritur rezultate, ji transparent dhe shoqëror, transfero njohuritë dhe aftësitë e tua. Kam vënë re se një pjesë e madhe e profesionistëve të cilët nuk punojnë më pranë Co-Plan janë ende të lidhur me organizatën dhe zotërojnë pozicione të mira në shoqërinë e sotme shqiptare. Prandaj, Co-Plan mund të konsiderohet si një platformë për zhvillimin

profesional. Përse më kërkon Co-Plan? Besoj se unë ofroj një vlerë të shtuar si edhe risi në punën time si konsulent menaxhimi (www.dbr.nl), pra unë evitoj atë që në Holandë e quajmë "të qënurit pjesë e mobiljeve të vjetra të zyrës".

Ç'mund të thoni për rolin tuaj në të ardhmen?

Jam i kënaqur me përfshirjen time në programin e ri të mbështetur nga "Fondi Think Tank" i SOROS, të quajtur Programi për Punë Kërkimore të Aplikuar në sferën e Politikë-Bërjes 2008-2010. Këtu unë mund të ofroj eksperiencën time në menaxhimin e kërkimit dhe hulumtimit, njohuritë e procesit të nismave dhe impakteve politike, si edhe trajnim dhe udhëheqje të studiuesve apo institucioneve. Ky program është i rëndësishëm për Co-Plan, pasi ai ndihmon organizatën të hyjë në fazën tjetër të zhvillimit të saj.





Vezir Muharremaj



Jorida Cila



Elona Saro



Oriana Arapi



Rudina Toto



Floreta Aliaj



Dorina Nikolla



Florian Ravoniku



Manjola Duli



Enton Derraj



Jonida Sinani



Eno Muho



Darina Kokona



Konalsi Gjoka



Anila Gjika



Oreola Caliqi



Amalia Tola



Rajmond Pengu



Etleva Goxhaj



Dritan Shutina

*Këtu mungon foto e Jorik Haska

FINANCAT DHE TRANSPARENCA



KPMG Albania Sh.p.k.
"Dëshmorët e Kombit" Blvd.
Twin Towers Buildings,
Building 1, 13th floor
Tirana, Albania

Telephone +355 4 274 524
+355 4 274 524
+355 4 226 524
E-mail aloffice@kpmg.com
Internet www.kpmg.al

Independent Auditors' Report

To The Executive Director of
Co-PLAN

Tirana, 20 April 2008

We have audited the accompanying financial statements of Co-PLAN Institute for Habitat Development (hereafter "the Organization" or "Co-PLAN"), which comprise the balance sheet as at 31 December 2007, the income statement and statement of cash flows for the year then ended, and a summary of significant accounting policies and other explanatory notes.

Management's Responsibility for the Financial Statements

Management is responsible for the preparation and fair presentation of these financial statements on the historical cost basis, following the accrual concept in accordance with the fund-accounting method. This responsibility includes: designing, implementing and maintaining internal control relevant to the preparation and fair presentation of financial statements that are free from material misstatements, whether due to fraud or error; selecting and applying appropriate accounting policies; and making accounting estimates that are reasonable in the circumstances.

Auditors' Responsibility

Our responsibility is to express an opinion on these financial statements based on our audit. We conducted our audit in accordance with International Standards on Auditing. Those standards require that we comply with relevant ethical requirements and plan and perform the audit to obtain reasonable assurance whether the financial statements are free of material misstatement.

An audit involves performing procedures to obtain audit evidence about the amounts and disclosures in the financial statements. The procedures selected depend on our judgment, including the assessment of the risks of material misstatement of the financial statements, whether due to fraud or error. In making these risk assessments, we consider internal control relevant to the entity's preparation and fair presentation of the financial statements in order to design audit procedures that are appropriate in the circumstances, but not for the purpose of expressing an opinion on the effectiveness of the entity's internal control. An audit also includes evaluating the appropriateness of accounting principles used and the reasonableness of accounting estimates made by management, as well as evaluating the overall presentation of the financial statements.

We believe that the audit evidence we have obtained is sufficient and appropriate to provide a basis for our opinion.

KPMG, Albania Sh.p.k., an Albanian limited liability company and a member firm of the global network of independent member firms affiliated with the KPMG network, a Swiss entity.



Opinion

In our opinion, the financial statements give a true and fair view of the financial position of the Organization as at 31 December 2007, and of its financial performance and its cash flows for the year then ended in accordance with the fund-accounting method.

Other Matters

This report is intended solely for the information and use of the Project's management and the donors of the Project. It is, therefore, not appropriate to rely on the contents for any other purposes and it should not, therefore, be further distributed without our prior written consent.

KPMG Albania Sh.p.k.

KPMG Albania Sh.p.k.

"Dëshmorët e Kombit" Blvd.
Twin Towers Buildings,
Building 1, 13th floor
Tirana, Albania

Raport i auditorëve të pavarur Për Drejtorin Ekzekutiv të Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit

TIRANË, MË 20 PRILL 2008

Ne kemi audituar bilancin kontabël të Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit (e quajtur këtej e tutje si "Organizata" ose "Co-PLAN") deri më 31 Dhjetor 2007, pasqyrën e të ardhurave dhe të fluksit të parave, për vitin në fjalë, si edhe një përmbledhje të politikave dhe standardeve të kontabilitetit dhe shënimeve të tjera shpjeguese.

Përgjegjësia e Strukturave Menaxhuese për Pasqyrat Financiare

Strukturat menaxhuese janë përgjegjëse për përgatitjen dhe prezantimin e saktë të pasqyrave financiare, bazuar në një kosto historike, sipas parimit të regjistrimit të dyfishtë, në përputhje me metodën "kontabilizim fondesh". Kjo përgjegjësi përfshin: dizenjimin, zbatimin, dhe mirëmbajtjen e kontrollit të brendshëm në lidhje me përgatitjen dhe prezantimin e saktë të pasqyrave financiare, pa gabime; përzgjedhjen dhe aplikimin e politikave dhe standardeve të përshtatshme; dhe vlerësimin financiar në përputhje me rrethanat.

Përgjegjësia e Kompanisë së Auditimit

Përgjegjësia jonë është të japim mendim mbi këto pasqyra financiare bazuar në auditimin tonë. Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standartet Ndërkombëtare të Auditimit. Sipas këtyre standarteve ne jemi të detyruar të planifikojmë dhe ushtrojmë auditimin për të arritur një siguri të arsyeshme mbi faktin nëse këto pasqyra financiare nuk përmbajnë gabime ose shmangie materiale.

Një auditim përfshin zbatimin e disa procedurave me qëllim marrjen e evidencës mbi shumat dhe paraqitjet në pasqyrat financiare. Proçedurat e përzgjedhura varen nga gjykimi ynë, duke përfshirë edhe vlerësimin e risqeve për shmangie materiale në pasqyrat financiare. Gjatë vlerësimit të këtyre risqeve, ne marrim në konsideratë kontrollin e brendshëm në lidhje me përgatitjen dhe paraqitjen e saktë të pasqyrave financiare me qëllim dizenjimin e procedurave të auditimit të cilat janë në përputhje me rrethanat, por jo me qëllimin për të shprehur një mendim mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të organizatës. Një auditim përfshin gjithashtu edhe vlerësimin e parimeve kontabël të përdorura dhe gjykimeve të rëndësishme të bëra nga strukturat menaxhuese, si edhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Ne besojmë që evidenca e auditimit e siguruar prej nesh siguron një bazë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të dhënë gjykimin tonë.


Vlerësimi

Sipas vlerësimit tonë, pasqyrat financiare japin një pamje të vërtetë dhe të saktë të gjendjes financiare të Organizatës deri më 31 Dhjetor 2007, si dhe të performancës së vet financiare dhe të fluksit të parave për vitin që mbyllet, në përputhje me metodën "kontabilizim fondesh".

Çështje të tjera

Ky raport lëshohet për informacion dhe përdorim vetëm të strukturave menaxhuese të Organizatës dhe për donatorët e saj. Rrjedhimisht, materiali nuk duhet përdorur për qëllime të tjera dhe për këtë arsye nuk duhet shpërndarë pa marrë më parë pëlqimin tonë me shkrim.

KPMG Albania sh.p.k
Rr. Dëshmorët e 4 Shkurtit
Kullat Binjake
Ndërtesa 1, Kati 13
Tiranë, Shqipëri



Projektet 2007

- 1 EGUG II – vazhdim “Drejt një Qeverisjeje të Mirë Urbane”
- 2 Programi për Decentralizim dhe Zhvillim Lokal: Projekti “Përgatitja e Planeve Lokale të Zhvillimit dhe Instrumentave të Menaxhimit të Territorit në gjashtë njësi vendore të Rajonit të Shkodrës”
- 3 Projekti i Ekstralegalitetit për Shqipërinë
- 4 Hapa drejt Rehabilitimit Urban dhe Integrimit të Komunitetit të Zonës Informale të Kënetës, Durrës
- 5 Hapa Drejt një Shoqërie Gjithëpërfshirëse në Elbasan: Integrimi i Grupeve të Prekura në Zhvillimin Urban
- 6 Forcimi i Kapaciteteve për një Qeverisje të Mirë Vendore
- 7 Energjitë e Qëndrueshme për Shqipërinë
- 8 Lehtësimi i Partneriteteve: Hartimi i Planit Rregullues të Qytetit të Beratit
- 9 NET Rrjeti për Shkëmbim dhe Trajnim

Emri i Projektit	Koha e Zbatimit	Donatori	Fondi	Zbatohet në
Drejt një Qeverisje të Mirë Urbane II - vazhdim	1 Janar 2007 – 31 Dhjetor 2008	Qeveria Holandeze nëpërmjet Ambasadës Holandeze në Tiranë	€ 215,996	Bashkia Fier Bashkia Elbasan

Qëllimi i projektit “Drejt një Qeverisje të Mirë Urbane II – vazhdim”, shkurt i quajtur EGUG II – vazhdim, është konsolidimi i modeleve të qeverisjes së mirë urbane të ngritur gjatë zbatimit të programit EGUG II në Bashkitë e Fierit dhe të Elbasanit gjatë periudhës 2003-2006. Kjo synohet të arrihet nëpërmjet vënies në jetë të Strategjisë së Zhvillimit të Qytetit (SZhQ). Gjatë vitit 2007, puna u përqëndrua në zbërthimin e Planit të Përgjithshëm Rregullues të Qytetit, i cilësuar si një nga instrumentat thelbësorë për një zhvillim të qëndrueshëm; në kryerjen e Analizës Institucionale të Bashkisë, përgatitjes së metodologjisë për hartimin e Planit të Investimeve Kapitale; zbatimit të procesit të Buxhetimit me Pjesëmarrje; si edhe asistencës në zbërthimin dhe monitorimin e Strategjisë së Zhvillimit të qytetit, gjithnjë duke mbështetur dhe zhvilluar kapacitetet vendore. Përpos objektivave të përmendura më poshtë, projekti synon edhe gjenerimin e fondeve apo projekteve nga të cilat do të përfitojnë Bashkitë e Fierit dhe të Elbasanit. Në këtë kuadër, janë mundësuar disa projekte nëpërmjet bashkëpunimit me donatorë të ndryshëm të cilët veprojnë në Shqipëri.

OBJEKTIVAT DHE TREGUESIT E PERFORMANCËS	
Objektivi 1 Institucionalizimi i procesit të Koordinimit dhe Monitorimit të Zbatimit të Strategjisë së Zhvillimit të Qytetit	
Treguesit e arritjes	➤ Zyra e Menaxhimit të Programit EGUG II, ku edhe u hartua Strategjia e Zhvillimit të Qytetit, është shndërruar në Departamentin e Koordinimit të Politikave dhe Zbatimit të Strategjisë, me një staf prej 9 punonjësish. ➤ Një aktivitet mbarëqytetar ku u prezantuan rezultatet e punës së Bashkisë bazuar në objektivat e Strategjisë së Zhvillimit për vitin 2007
Objektivi 2 Përmirësimi i kapaciteteve vendore për zbërthimin e Planit të Përgjithshëm Rregullues të Qytetit	
Treguesit e arritjes	➤ Plani i Përgjithshëm Rregullues i Qytetit të Fierit, së bashku me Rregulloren e këtij Plani, miratohen në KRTRSh më 26 Tetor 2007. ➤ Dy “Propozime për Zhvillim” për dy nga nyjet më të rëndësishme hyrëse të qytetit të Fierit janë përgatitur sipas një metodologjie bashkëkohore. ➤ Organizimi i një aktiviteti në shkallë kombëtare mbi Zhvillimin Urban në qytetin e Fierit, me praninë e arkitektëve, ndërtuesve dhe investitorëve të ndryshëm. ➤ Asistencë e vazhdueshme në punë për stafin lokal

Objektivi 3 Forcimi organizativ nëpërmjet zhvillimit të Sistemit të Informacionit Bashkiak	
Treguesit e arritjes	➤ Përgatitja e Metodologjisë për kryerjen e Analizës Institucionale të Bashkisë ➤ Përgatitja e një programi kompjuterik që funksion si bazë të dhënash institucionale ➤ Seanca të vazhdueshme konsultimesh, trajnimesh dhe asistence në punë për stafin lokal ➤ Draft dokumenti i Analizës Institucionale
Objektivi 4 Përmirësimi i Menaxhimit Financiar Bashkiak	
Treguesit e arritjes	➤ Një dokument metodologjik për analizimin e situatës financiare të Bashkisë ➤ Një dokument metodologjik për hartimin e Planit të Investimeve Kapitale
Objektivi 5 Gjenerimi i fondeve / projekteve të tjera, bazuar në zbatimin e SZhQ	
Treguesit e arritjes	➤ Tre projekte të mëdha janë gjeneruar nga të cilat do të përfitojnë të dyja Bashkitë, si në forcim kapacitetesh ashtu edhe në investime konkrete

*Buxhetimi me Pjesëmarrje është trajtuar nën Projektin "Bashkëveprimi Ndërkomunor në Qeverisjen Vendore dhe Zhvillimi Rajonal" duke qënë se për vitin 2007 është financuar nga OSFA/SOROS.





Emri i Projektit	Koha e Zbatimit	Donatori	Fondi	Zbatohet në
"Përgatitja e Planeve Lokale të Zhvillimit dhe Instrumentave të Menaxhimit të Territorit në 6 njësi vendore të Rajonit të Shkodrës"	Maj 2007 – Maj 2008	INTERCOOPERATION Albania – Programi për Decentralizim dhe Zhvillim Lokal	€ 160,796	Bashkia Koplik Bashkia Pukë Bashkia Fushë-Arrëz Bashkia Vau-Dejë Komuna Guri i Zi Komuna Dajç Bregu i Bunës

Programi për Decentralizimin dhe Zhvillimin Lokal në Rajonin e Shkodrës (DLDP), i financuar nga Agjensia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim dhe i zbatuar nga Intercooperation Albania synon të mbështesë tetë Bashki dhe Komuna të këtij rajoni verior të Shqipërisë për përmirësimin e komponentëve të qeverisjes vendore, menaxhimit dhe administrimit të shërbimeve. Për këtë qëllim, në fillim të projektit është kryer një vlerësim i detajuar i të gjitha njësive vendore për të identifikuar nevojat e tyre kryesore dhe prioritetet. Në kuadër të programit është parashikuar mbështetja e gjashtë njësive vendore për përgatitjen e "Planeve të Zhvillimit Lokal" si dhe dy Planeve të Përgjithshëm Rregullues nëpërmjet pjesëmarrjes së gjerë në proces të aktorëve vendorë. Qëllimi kryesor i këtij projekti është "të përgatisë dokumentat strategjikë që identifikojnë prioritetet kyçe të zhvillimit për njësitë vendore të përzgjedhura në projekt dhe që orientojnë zhvillimet e ardhshme ekonomike, përmirësimin e infrastrukturave fizike dhe sociale, shpërndarjen e shërbimeve publike, planifikimin dhe menaxhimin e territorit".

OBJEKTIVAT DHE TREGUESIT E PERFORMANCËS

Objektivi 1

Përgatitja e Planeve të Zhvillimit Lokal për çdo Njësi Vendore të përzgjedhur në Projekt

Treguesit e arritjes	➤ Gjashtë Grupe Pune, me rreth 20-25 ekspertë vendorë, janë ngritur dhe funksionojnë me qëllim hartimin e Planeve të Zhvillimit ➤ Gjashtë dokumenta të Analizës së Përgjithshme, nga një dokument për secilën njësi vendore, janë hartuar nga Grupet e Punës ➤ 24 seminare, me pjesëmarrjen e mbi 260 qytetarëve, janë organizuar ku janë prezantuar dhe diskutuar skenarët e zhvillimit strategjik lokal ➤ Gjashtë grupe prioritetesh zhvillimi janë identifikuar për secilën njësi vendore të përzgjedhur në projekt
----------------------	---

Objektivi 2

Përgatitja e Planeve të Përgjithshëm Rregullues për dy nga njësitë vendore të Projektit

Treguesit e arritjes	➤ Dy Baza të Dhënash të nevojshme për përgatitjen e Planeve të Përgjithshëm Rregullues janë ngritur sipas sistemit GIS ➤ Dy draft skema për të dy qytetet janë përgatitur duke përcaktuar tipologjitë ekzistuese urbane dhe ato të propozuara ➤ Dy drafte të Detyrave të Projektimit janë përgatitur dhe do të paraqiten Bashkive dhe Këshillave Lokalë në fillim të muajit Janar 2008
----------------------	--



Emri i Projektit	Koha e Zbatimit	Donatori	Fondi	Zbatohet në
Projekti i Ekstra-legalitetit për Shqipërinë	Prill – Tetor 2007	Qeveria e Shqipërisë nëpërmjet OSI-ZUG	\$ 85,000	Tiranë, Elbasan, Shkodër, Vlorë, Korçë dhe Sarandë

Ky projekt ndërmerret në kuadër të “Programit për Kalimin drejt Shtetit të së Drejtës dhe një Ekonomie Tregu Gjithëpërfshirëse në Shqipëri” që është një nismë për reformë institucionale. Diagnoza mbi ekonominë ekstra-ligjore në Shqipëri udhëhiqet nga Instituti Peruan për Liri dhe Demokraci (ILD) ndërkohë që projekti është zbatuar nga Departamenti i Legalizimit & Formalizimit të Ekonomisë Extraligjore, pranë Këshillit të Ministrave. Roli i Co-PLAN ka konsistuar në kryerjen e një studimi mbi matjet e ekstra-legalitetit në çështjet e pronësisë dhe biznesit në gjashtë qytete të vendit. Qëllimi i projektit është të identifikojë përmasat e ekstra-legalitetit në çështje të pronësisë dhe biznesit si edhe të kuptojë dhe përcjellë këndvështrimet e grupeve të ndryshme të interesit për proceset e legalizimit, kthimit dhe kompensimit të pronës, rregjistrimit fillestar të pasurisë, transparencës, dhe tregut të tokës urbane dhe asaj rurale. Ky projekt ka mundësuar vlerësimin e situatës për të matur përmasat e “kapitalit të vdekur” në sektorin e pasurive të paluajtshme dhe biznesit, duke përshkruar se si biznesmenët dhe pronarët shqiptarë i përdorin asetet e tyre për qëllime ekonomike. Përveç kësaj, Co-PLAN është angazhuar edhe për organizimin e 15 tryezave të rrumbullakëta me grupet e interesit në çështjet e sipërpërmendura.

OBJEKTIVAT DHE TREGUESIT E PERFORMANCËS

Objektivi 1

Të lehtësojë organizimin e tryezave të rrumbullakëta me grupet e përcaktuara të interesit dhe të paraqesë me anë të raporteve pikëpamjet e tyre, me qëllim identifikimin e pengesave për një funksionim të mirë të sistemit të pronësisë

Treguesit
e arritjes

- 15 tryeza të rrumbullakëta mbi çështjet e pronësisë me pjesëmarrjen e rreth 90 ekspertëve
- 15 raporte cilësore mbi evidentimin e problematikave në këtë fushë dhe hartimi i rekomandimeve përkatëse
- 4 konsulentë u identifikuan dhe kontraktuan për të asistuar në çështje të tregut të tokës, planifikimit urban dhe tregut të banesave

Objektivi 2

Përgatitja e Planeve të Përgjithshëm Rregullues për dy nga njësitë vendore të Projektit

Treguesit
e arritjes

- Një manual trajnimi i përgatitur
- 2,680 pyetësorë të plotësuar në 6 qytete



Emri i Projektit	Koha e Zbatimit	Donatori	Fondi	Zbatohet në
Hapa drejt Rehabilitimit Urban dhe Integrimit të Komunitetit të Zonës me Zhvillim Informal Kënetë, Durrës	Maj 2004 – Qershor 2008	Qeveria Austriake nëpërmjet Agjensisë Austriake për Zhvillim (ADA) Bashkia e Durrësit	€ 351,748 € 52,000	Zona Informale Kënetë, Durrës

Zona e Kënetës është hapësira më e madhe me zhvillim informal me popullsi mbi 30 mijë banorë dhe sipërfaqe rreth 350 hektarë në qytetin e Durrësit; dhe ky projekt zbatohet në një zonë pilot prej 50 hektarësh. Qëllimi i projektit është “Krijimi i modelit për integrimin urban të një zone informale, nëpërmjet përfshirjes dhe fuqizimit të komunitetit në procesin e hartimit të planit urban”, dhe ai synon integrimin e komunitetit të zonës me strukturat formale të Bashkisë Durrës nëpërmjet proceseve të legalizimit dhe urbanizimit të zonës. Për këtë qëllim, Co-PLAN në bashkëpunim me Bashkinë e Durrësit, po punon për planifikimin urban si edhe kryerjen e ndërhyrjeve për përmirësimin e infrastrukturës bazë, me pjesëmarrjen e komunitetit. Gjatë vitit 2007, projekti u përqëndrua në realizimin e tre komponentëve kryesorë si procesi i legalizimit; ndërhyrjet në infrastrukturë; dhe proceset pjesëmarrëse me banorët e zonës dhe Bashkinë. Zona në të cilën zhvillohet projekti i Kënetës është zonë e cila ka tërhequr pjesën më të madhe të investimeve të Bashkisë së Durrësit, gjatë muajve të fundit. Metodologjia e përdorur gjatë realizimit të këtij projekti ka tërhequr interesin e Qeverisë Shqiptare, dhe zona e Kënetës është konsideruar nga ALUZINI si një zonë pilot në nivel kombëtar, për zbatimin e Ligjit të Legalizimeve.



OBJEKTIVAT DHE TREGUESIT E PERFORMANCËS

Objektivi 1

Asistencë për pushtetin lokal dhe qëndror në zbatimin e ligjit të ri të legalizimeve dhe aprovimi i studimit urbanistik pjesor për lagjen

Treguesit
e arritjes

- Materialet grafike dhe raporti për Studimin Urban Pjesor janë përfunduar dhe shpërndarë tek aktorët kryesorë, si Bashkia e Durrësit dhe ALUIZNI
- Dy trajnime të zhvilluar me stafin lokal të ALUIZNI për përgatitjen e bazës elektronike dhe hartografike të të dhënave
- Detyra e projektimit për Studimin Urbanistik Pjesor ka kaluar për aprovim pranë KRrTRSh.

Objektivi 2

Përmirësimi i infrastrukturës në zonën pilot

Treguesit
e arritjes

- Dy projekte teknike të përgatitura për investime në rrjetin rrugor dhe pastrimin e kanaleve të drenazhimit
- Një skemë e përgatitur për sistemin e mbledhjes së mbeturinave
- 3,000 m kanale drenazhimi të pastruara
- 1,200 m2 hapësirë publike krijuar për banorët e zonës
- 12,800 m2 rrugë të përmirësuar në lagje; 24,000 m2 rrugë të mbushura me çakëll në zonën e projektit
- Bashkia e Durrësit ndërhyr me katër investime madhore në zonë

Objektivi 3

Organizimi dhe ngritja e kapaciteteve vendore për pjesëmarrjen e tyre në proceset e integritimit dhe zhvillimit të lagjes, nëpërmjet hartimit të Programit të Zhvillimit të Lagjes

Treguesit
e arritjes

- Finalizimi i dokumentit të Programit të Zhvillimit të Lagjes
- Katër trajnime për ngritjen e kapaciteteve organizuar në bashkëpunim me CSDC
- 200 familje, banuese në zonë, të përfshira në proces
- Dy ditë trajnim për lobim dhe partneritet në Maqedoni; Kurse të gjuhës së huaj për studentë
- Dy aktivitete masive mjedisore të organizuara me mbi 180 pjesëmarrës
- Një studim social – ekonomik për zonën, i bazuar në 385 pyetësorë
- Një platformë për integrimin e të rinjve është hartuar, bazuar në një studim të të rinjve nga zona e Kënetës, Porto Romanos dhe Spitallës (257 pyetësorë)

Objektivi 4

Përhapja e njohurive tek palët e interesuara

Treguesit
e arritjes

- Dy numra të Buletinëve Informativë, me rreth 1,000 kopje të shpërndara
- Tre emisione televizive lokale; Mediat Austriake prezantojnë rezultatet e projektit të Kënetës
- Një vizitë e drejtorit ekzekutiv të ADA, Z. Linhart; Dy vizita të zyrtarëve të lartë të ADA
- Një projekt propozim është hartuar me qëllim vazhdimësinë e projektit





Emri i Projektit	Koha e Zbatimit	Donatori	Fondi	Zbatohet në
Hapa Drejt një Shoqërie Gjithëpërfshirëse në Elbasan: Integrimi i Grupeve të Prekura në Zhvillimin Urban	Dhjetor 2006 - Dhjetor 2008	CORDAID Bashkia e Elbasanit	€ 247, 538 Lekë 5 milionë	Bashkia e Elbasanit

Hartimi dhe zbatimi i këtij projekti bazohet në Strategjinë e Zhvillimit të Qytetit të Elbasanit, të hartuar në kuadër të programit EGUG II, si edhe në Strategjinë Kombëtare për Përmirësimin e Kushteve të Jetesës së Minoritetit Rom. Projekti është në zbatim në lagjen 5 Maji ku është i vendosur komuniteti Rom, i karakterizuar nga probleme të ndryshme të natyrës social – ekonomike dhe të aksesit në shërbime publike, të lidhura me situatën informale të kësaj lagjeje. Ky projekt synon realizimin e aktiviteteve që çojnë në integrimin e këtij komuniteti në zhvillimin e mëtejshëm urban të qytetit dhe të ndihen në të ardhmen qytetarë të barabartë të tij. Dy nga përmasat kryesore të projektit janë edhe realizimi i investimeve konkrete në zonë, bazuar në identifikimin e prioritetëve në komunitet, si dhe hartimi dhe botimi e një dokumenti lokal mbi planifikimin e zhvillimit të lagjes, i cili do të jetë në përputhje me dokumentin kombëtar të strategjisë mbi romët në Shqipëri dhe do të shërbejë si një instrument matës në nivel lokal mbi arritjen e objektivave. Pjesë integrale e projektit është edhe asistenca për rritjen e kapaciteteve të popullsisë Rome me qëllim rritjen e rolit të tyre në vendim-marrjen vendore, si edhe të pushtetit lokal me qëllim ndërtimin e urave të qëndrueshme të bashkëpunimit institucional mes autoriteteve lokale dhe përfaqësuesve të komunitetit Rom në zonë.



OBJEKTIVAT DHE TREGUESIT E PERFORMANCËS

Objektivi 1

Të nxisë dhe aftësojë pjesëmarrjen e komunitetit Rom në proceset e vendim-marrjes

Treguesit
e arritjes

- 15 takime të organizuara me komunitetin Rom në zonë si edhe përfaqësuesit e tyre
- 2 trajnime me banorët e zonës; rreth 60 pjesëmarrës

Objektivi 2

Të fuqizojë kapacitetet vendore mbi politikë-bërjen dhe praktikat që adresojnë nevojat e komunitetit Rom në shoqëri

Treguesit
e arritjes

- Dy manuale mbi çështjen Rome për përdorim të Bashkisë së Elbasanit
- Përfaqësues të komunitetit Rom marrin pjesë aktive në procesin e Buxhetimit me Pjesëmarrje

Objektivi 3

Të rrisë ndërgjegjësimin dhe aftësitë lobuese mes të gjithë aktorëve lokalë dhe qytetarëve mbi çështjen Rome

Treguesit
e arritjes

- Një performancë sensibilizuese publike e organizuar në lulishten kryesore të qytetit me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Romëve
- 1000 qytetarë Romë morën pjesë në këtë aktivitet
- Krijimi i rrjetit të partnerëve që punojnë mbi çështjen Rome në zonë

Objektivi 4

Të përmirësojë aksesin e qytetarëve Romë në infrastrukturën fizike dhe atë sociale me qëllim përmirësimin e kushteve të jetesës

Treguesit
e arritjes

- Një studim social-ekonomik i zonës bazuar në 150 pyetësore
- Bashkëpunim me pedagogë dhe studentë të Universitetit të Elbasanit për kryerjen e studimit
- 5 fusha prioritare të listuara nga komuniteti Rom, ku do të bazohen investimet në zonë
- 6 projekte teknike të përgatitura për ndërhyrjet në zonë

Emri i Projektit	Koha e Zbatimit	Donatori	Fondi	Zbatohet në
Forcimi i Kapaciteteve për një Qeverisje të Mirë Vendore	Janar – Dhjetor 2007	OSFA/SOROS	\$ 71,240	Bashkia e Fierit Bashkia e Durrësit Bashkia e Korçës Bashkia e Pogradecit Bashkia e Lezhës

Pushtetet vendore ndeshen me sfida të mprehta, ku nga njëra anë procesi i decentralizimit ofron më shumë kompetenca dhe përgjegjësi për garantimin e shërbimeve dhe menaxhimin e territorit, e nga ana tjetër kapacitetet vendore nuk arrijnë të përgjigjen me efikasitet këtyre sfidave dhe zhvillimeve. Njëkohësisht, vihet re një nevojë për angazhimin e shoqërisë civile, për transparencë dhe përgjegjshmëri sociale. Ky projekt vjen pikërisht me qëllim mbështetjen e njësive vendore në çështje që kanë të bëjnë me planifikimin dhe menaxhimin e territorit, menaxhimin e informacionit dhe formulimin e buxhetit vendor nëpërmjet një procesi me pjesëmarrje. E thënë ndryshe, ky projekt synon rritjen e kapaciteteve vendore në fushën e qeverisjes si edhe përhapjen e eksperiencave të zhvilluara nga Co-PLAN në këto fusha me bashki të tjera. Projekti gjithashtu synon rritjen e transparencës lokale, përgjegjshmërisë dhe ndërgjegjësimit qytetar në fushën e qeverisjes vendore.

OBJEKTIVAT DHE TREGUESIT E PERFORMANCËS

Objektivi 1

Të forcohen kapacitetet menaxhuese të njësive vendore veçanërisht në çështje të planifikimit urban, ngritjes dhe menaxhimit të sistemeve të informacionit dhe buxhetimit

Treguesit e arritjes

- Tre paketa trajnimesh dhe manuale të përgatitura në fushat e hartimit të Planeve Rregulluese; Sistemeve të Informacionit në Bashki dhe Buxhetimit me Pjesëmarrje
- Katër Bashki, ato të Korçës, Pogradecit, Durrësit dhe Lezhës, me rreth 60 përfaqësues janë përfituese të këtyre trajnimeve

Objektivi 2

Të rritet transparencia e njësive vendore me anë të zbatimit të mekanizmave me pjesëmarrje dhe atyre monitoruese

Treguesit e arritjes

- Një dokument metodologjie për zbatimin e procesit të Buxhetimit me Pjesëmarrje në Bashkinë e Fierit
- Rreth 700 qytetarë marrin pjesë në proces
- 10,000 fletëpalosje dhe 140 postera informues dhe ndërgjegjëses
- Dhjetë projekte të propozuara nga qytetarët gjejnë financim nëpërmjet buxhetit të Bashkisë për vitin 2008, me një vlerë totale prej 50 milionë Lekë

Objektivi 3

Fushatë sensibilizimi në çështjet e qeverisjes vendore dhe transparencës lokale

Treguesit e arritjes

- Dy debate televizive të organizuara në NEWS 24 mbi çështjet e menaxhimit urban
- Dy debate televizive të organizuara në Vizion + në fushën e qeverisjes vendore
- Katër artikuj të publikuar në "Metropolitan", "MAPO", etj.



Emri i Projektit	Koha e Zbatimit	Donatori	Fondi	Zbatohet në
Energjitë e Qëndrueshme për Shqipërinë	Janar 2006 – Dhjetor 2007	Cordaid	€ 199,577	Studim në nivel kombëtar

Pamundësia e sistemit tonë elektroenergjitik për të përballuar kërkesën gjithnjë në rritje për energji, aftesitë e kufizuara të tij në importin e energjisë si edhe humbjet e shumta teknike dhe jo teknike, kanë sjellë padyshim një kolaps në energjitikën shqiptare. Kriza energjitike që logjikisht ka pasuar këtë gjendje gjithashtu ka rrjedhur edhe nga një mungesë vizioni për të adresuar çështjet energjitike dhe impaktet e tyre në zhvillimin ekonomik të vendit përmes vendimeve strategjike për të investuar në forma të tjera alternative. Projekti “Energjitë e Qëndrueshme për Shqipërinë” synon të ofrojë një koncept të ri në politikat energjitike Shqiptare, atë të prodhimit të decentralizuar të energjisë. Projekti gjithashtu synon të japë një tjetër këndvështrim të zhvillimit të sektorit energjitik duke marrë në konsideratë edhe burimet e rinovueshme të energjisë, në ndryshim nga Strategjia Kombëtare e Energjisë që është e kufizuar vetëm në mënyrën e centralizuar të prodhimit të energjisë duke u mbështetur në burime tradicionale. Në përfundim të tij, projekti ka për qëllim të arrijë rritjen e ndërgjegjësimit të opinionit publik, profesionistëve dhe autoriteteve përkatëse mbi çështjen e energjive të rinovueshme (përfshire edhe prodhimin e H2 nga burimet e rinovueshme të energjisë) duke stimuluar zhvillim në fushën ekonomike dhe atë të mjedisit në Shqipëri.



OBJEKTIVAT DHE TREGUESIT E PERFORMANCËS

Objektivi 1

Krijimi i mundësive për prodhimin e decentralizuar të energjisë në Shqipëri, si një alternativë e Strategjisë Kombëtare të Energjisë

Treguesit e arritjes

- Botohet studimi mbi “Vlerësimin e Potencialëve të Burimeve të Rinovueshme të Energjisë në Vendin tonë”
- Një studim mbi mundësinë e prodhimit të Hidrogjenit nga burimet e rinovueshme të energjisë si edhe të përdorimit të tij si burim energjie për të ardhmen.
- Ndërtimi i një plani veprimi që do të stimulonte përdorimin e burimeve të rinovueshme të energjisë në sektorë të ndryshëm të ekonomisë.
- Hartimi i një dokumenti politikash për përdorimin e burimeve të rinovueshme të energjisë.
- Nënshkrimi i Marrëveshjes së Bashkëpunimit me Agjencinë Kombëtare të Energjisë si edhe pjesëmarrje aktive në grupet e punës për përditësimin e Strategjisë Kombëtare të Energjisë
- Hartimi i 3 skenarëve të bazuar në përdorimin e burimeve të rinovueshme për të prodhuar energji në mënyrë të decentralizuar
- Krijimi dhe mirëmbajtja e një sistemi të dhënash mbi burimet e rinovueshme të energjisë.
- 13 harta në GIS të hartuara për çdo burim të rinovueshëm energjie

Objektivi 2

Theksimi i rëndësisë mbi rolin e energjive të rinovueshme në furnizimin me energji në Shqipëri në terma afatgjatë

Treguesit e arritjes

- Një takim kombëtar dhe një tryezë e rrumbullakët mbi energjitë e rinovueshme, efciensën e energjisë, dhe hyrjen dhe përdorimin e teknologjive të reja të cilat përdorin burimet e rinovueshme të energjisë në vendin tonë
- Prodhimi i tre dokumentarëve të shkurtër lidhur me përdorimin e burimeve të rinovueshme të energjisë në vendin tonë
- Një ekspozitë mbi burimet e rinovueshme të energjisë dhe përdorimin me efciensë të energjisë në sektorin e bane-save
- Transmetimi i dokumentarit “Revolucioni i Hidrogjenit” në televizione dhe salla të mbyllura
- Pjesëmarrja në tre debate televizive mbi çështjet e energjisë
- Tre artikuj të botuar në gazetatat e përditshme
- Shpërndarja e mbi 300 kopjeve të studimit mbi energjitë e rinovueshme dhe hartave në institucionet kryesore në vend, në universitete dhe tek ekspertë të fushave të ndryshme





Emri i Projektit	Koha e Zbatimit	Donatori	Fondi	Zbatohet në
Lehtësimi i Partneriteteve: Hartimi i Planit të Përgjithshëm Rregullues të Qytetit të Beratit	Qershor 2006 – Qershor 2007	OSFA/SOROS	€ 100,000	Berat

PHartimi i Planit të Përgjithshëm Rregullues të Qytetit të Beratit është pjesë e programit “Lehtësimi i Partneriteteve”, zbatimi i të cilit ka filluar në vitin 2005. Gjatë vitit 2007, ky program u përqëndrua në Bashkinë e Beratit, qytet i cili po përballet me pasojat e largimit të popullsisë. Për këtë qëllim projekti synonte të ndërmerre një proces të planifikimit me pjesëmarrje për të rigjallëruar qendrat urbane dhe për të mbrojtur trashëgiminë kulturore të Beratit. Konceptimi i këtij projekti erdhi me kërkesën e vetë Bashkisë së këtij qyteti. Megjithëse ishte parashikuar që Co-PLAN të finalizonte Planin Rregullues të qytetit, përfshirja e Beratit në listën e qyteteve të cilat do të përfitojnë nga fondi i Bankës Botërore nëpërmjet projektit të Administrimit dhe Menaxhimit të Tokës, angazhimi i Co-PLAN u mbyll me finalizimin e Detyrës së Projektimit. Puna u përqëndrua në mobilizimin dhe organizimin e procesit, nëpërmjet një strukture bazë dhe një grupi pune ndër-sektorial. Vëzhgime, analiza dhe studime social-ekonomike u përdorën për hartimin e Detyrës së Projektimit, e cila pati edhe miratimin e KRrTRSh

OBJEKTIVAT DHE TREGUESIT E PERFORMANCËS

Objektivi 1

Hartimi i Detyrës së Projektimit për Planin e Përgjithshëm Rregullues të Qytetit të Beratit

Treguesit e arritjes	- Një studim social-ekonomik i qytetit të Beratit bazuar në 800 pyetësorë me familjet - Krijimi i një baze të dhënash bazuar mbi analizën e situatës 26 departamente, institucione dhe ndërmarrje vendase të intervistuar 3 grupe tematike të ngritura 33 harta tematike - Miratimi i Detyrës së Projektimit në KRrTRSh
----------------------	--

Objektivi 2

Fuqizimi i Kapaciteteve në Nivel Vendor

Treguesit e arritjes	3 seminare të organizuara me stafin e Bashkisë - Asistencë e vazhdueshme në punë për grupin e punës - Dhjetë projekte të propozuara nga qytetarët gjejnë financim nëpërmjet buxhetit të Bashkisë për vitin 2008, me një vlerë totale prej 50 milionë Lekë
----------------------	---

Objektivi 3

Krijimi i një Modeli për tu përhapur në Njësi të tjera Vendore

Treguesit e arritjes	- Pjesëmarrje në konferencën rajonale “Qeverisja e Mirë me Pjesëmarrje” - Pjesëmarrje në forumin urban “Qyteti i së Nesërme” - Katër artikuj të botuar në Gazetën Bashkiake - Pesë emisione televizive të transmetuara 2 Marrëveshje me Fakultete të Arkitekturës dhe Planifikimit Urban
----------------------	--



Emri i Projektit	Koha e Zbatimit	Donatori	Fondi	Zbatohet në
NET Rrjeti për Shkëmbime dhe Trajnim	Janar 2004	Cordaid	€ 450,000	Konsulencë dhe trajnime të ofruara në të gjithë vendin
	–	Co-PLAN	€ 100,000	
	Dhjetor 2007	Gjeneruar nga të tretë	€ 145,506	

NET është themeluar në vitin 2004, si një program i përbashkët i Co-PLAN and Cordaid (Holandë). Fokusi i aktiviteteve të NET ka qënë trajnimet dhe shërbimet e konsulencës në fushën e menaxhimit dhe zhvillimit organizativ, së bashku me aktivitete të cilat synojnë të promovojnë vlera të rëndësishme për shoqërinë. NET fokusohet në dy fusha kryesore: (i) Trajnime dhe Ngritje Kapacitetesh në nivelin e aftësive por edhe atë përmbytësor, në fushat e menaxhimit të përgjithshëm, zhvillimit organizativ, menaxhimit të ciklit të projekteve, proceset e planifikimit strategjik, shkrim projekt-propozimesh, planifikim biznesi, menaxhim financiar, dhe komunikim; dhe (ii) Proçese të cilat ndihmojnë identifikimin dhe promovimin e vlerave të rëndësishme për mbarë shoqërinë, siç është çmimi vjetor i Lidershipit Shqiptar.

Një numër i madh organizatash dhe individësh kanë përfituar nga shërbimet e ofruara nga NET. Nga këto mund të përmendim, partnerët e rrjetit të Cordaid dhe ICCO në Shqipëri, World Vision, SNV, Dorcas Aid Albania, Komiteti Shqiptar i Helsinkit, Refleksione, British Council, Banka Raiffeisen, Abisnet, GlaxoSmithKline dhe shumë të tjerë.

OBJEKTIVAT DHE TREGUESIT E PERFORMANCËS

Objektivi 1

Identifikimi dhe ofrimi i aktivitete të cilat mundësojnë shkëmbimin e informacionit, rrjetëzimin, si edhe përhapjen e njohurive

Treguesit
e arritjes

- Komiteti i Lidershipit Shqiptar për vitin 2007 i përbërë nga figura të njohura publike, vlerësoi 158 kandidatura të nominuara nga publiku i gjerë nëpërmjet një proçesi të hapur dhe transparent
- Katër çmime të akorduara për të katër fushat
- Rreth 130 persona dhe mjaft media vizive e të shkruara morën pjesë në ceremoninë e ndarjes së çmimeve

Objektivi 2

Zhvillimi dhe ofrimi i trajnimeve, asistencës teknike, dhe ngritjes së kapaciteteve me qëllim mbështetjen e zhvillimit institucional dhe organizativ

Treguesit
e arritjes

- Tre kurrikula të reja trajnimesh u ofruan për herë të parë gjatë vitit 2007 ("Teknikat e Intervistimit" "Biseda për Shitje të Suksesshme" dhe "Vendim-marrje Efektive")
- Janë organizuar 11 trajnime të hapura me rreth 90 pjesëmarrës nga 28 organizata; si edhe shtatë trajnime në kompani
















2007

RAPORTI VJETOR



Co-PLAN INSTITUTI PER ZHVILLIMIN E HABITATIT